R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë
**BASHKIA KOLONJË**

**PROJEKT - VENDIM**

**Nr. _____ Datë ___/ ___/ 2025**

**"PËR DHËNIE DAKORDËSIE PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR PRIVATIZIMIN E PASURISË NR. 6/40 , Z.K. 2430 LESKOVIK, ME SIP. TRUALLI 367.46 M2, KU NGA KJO 112.47 M2 ËSHTË NDËRTESË, TË OBJEKIT ME EMËRTIMIN "ZYRA TË ISH-FERMËS LOKALE FRUTI-KULTURË ".**

Në mbështetje të ligjit Nr. 139/2015 "**Për Vetëqeverisjen Vendore**", Vendim Të Këshillit Të Ministrave Nr. 819, datë 29.11.2007 "**Për privatizimin e pasurivë të ndërmarrjeve apo të institucioneve shtetërore**" si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926 datë 29.12.2014 "**Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo kalohet dhe procedurë e shitjes"** bazuar në kërkesën Nr. 4998 Prot., datë 25.10.2024, me propozim të Kryetarit të bashkisë, Këshilli i Bashkisë Kolonjë, në mbledhjen e datës 30.06.2025,

**PROPOZOI:**

1. Miratimin e kërkesës për vazhdimin e procedurave për privatizimin e pasurisë nr. 6/40, Z.K 2430 Leskovik, me Sipërfaqe trualli 367.46 m2, nga ku 112.47 m2 ndërtesë, të objektit me emërtimin "Zyra të ish-fermës lokale fruti-kulturë".
2. Për zbatimin e këtij p/vendimi ngarkohen administrata e Bashkisë Kolonjë dhe Kryetari i Bashkisë.
3. Ky p/vendim hyn në fuqi në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".

**KRYETARI**

**ERION ISAI**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**
**NËNKRYETAR**
**PETRO RISTO**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA KOLONJË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA KOLONJË**

Nr.3073 prot.　　　　　　　　　　　　　　　　　　　　　　Ersekë, më 25.06.2025

**RELACION**

**PËR**

**PROJEKT-VENDIM**

**Nr.___ Datë ___.___.2025**

**"PËR DHËNIE DAKORDËSIE PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR PRIVATIZIMIN E PASURISË NR. 6/40 , Z.K. 2430 LESKOVIK, ME SIP. TRUALLI 367.46 M2, KU NGA KJO 112.47 M2 ËSHTË NDËRTESË, TË OBJEKIT ME EMËRTIMIN "ZYRA TË ISH-FERMËS LOKALE FRUTI-KULTURË ".**

*Të nderuar!*

Në mbështetje të ligjit Nr. 139/2015 "**Për Vetëqeverisjen Vendore**", Vendim Të Këshillit Të Ministrave Nr. 819, datë 29.11.2007 "**Për privatizimin e pasurivë të ndërmarrjeve apo të institucioneve shtetërore**" si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926 datë 29.12.2014 "**Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo kalohet dhe procedurë e shitjes**" me propozim të Kryetarit të bashkisë, referuar kërkesës së Drejtorisë së Përgjithshme të pronës shtetërore, Drejtorisë së Privatizimit, ku kjo pronë në pamundësi për tu mirëmbajtur apo investuar nga ana e Bashkisë Kolonjë, I kërkojmë Këshillit të Bashkisë Kolonjë dakordësi që të fillohet procedura për privatizimin e pronës me pasurinë nr. 6/40 , z.k. 2430 leskovik, me sip. trualli 367.46 m2, ku nga kjo 112.47 m2 është ndrtesë, të objekit me emërtimin "zyra të ish-fermës lokale fruti-kulturë .

**Ju falenderojmë!**

Konceptoi: L.Bendo Specialist D.P.ZH.T.M
K. Brame Specialist D.P.ZH.T.M
Kontrolloi: Drejtori D.P.ZH.T.M Ing.M.Tartari
Konfirmoi: Drejtori D.Ç.J.P.P O.Lifo

**KRYETARI**

**ERION ISAI**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**
**NËNKRYETAR**
**PETRO RISTO**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA KOLONJË

# 1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN DHE TRANSFERIMIN E AMBJENTEVE ADMINISTRATIVE PRONESI TE NJESIVE VENDORE

Bashkia / Komuna Leskovik

Identifikuar: Stavri Cece Z. Urbanistikës
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Supervizuar: ____________________
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Aprovuar: Vladimir Vezuli
Kryetari i Komunës

| Nr. | Emri i Prones<br>Adresa<br>Pronari | Sip. Totale Pasurise (m2) | Nga Sip. Totale: Sa Truall (m2) | Nga Sip Totale Sa Ndertese (m2) | Rendija e ambjenteve brenda prones sipas fegmesit te planimetrise | Lloji i prones (ambjenteve administrative) sipas perdorimit aktual / funksionit | Institucioni qe ushtron autoritet administrativ mbi ndertesen ose mjedisin | Kerkohet per Transferim |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 |
| | Ambientet e Komunës Blloku Nr 3 Leskovik | 178.2 | 66.2 | 112 | Komuna | Zyra e Komunës | Komuna Leskovik | Inventarizim dhe transferim |

KRYETARI AITPP
VLADIMIR KOIVONI
[signature]

# PLANIMETRIA E KATIT TE PARE TE [illegible] JE KOMUNEJ LESKOVIK

Shk 1:100





Ing Muhorrem Tortori
Nr. liç. Z 3267

Shënim: Kati përdhe është i njëjtë me katin e parë
KRYETARI AITPP
VLADIMIR KONOMI

PLAN VENDOSJA




Ing. Muharrem Tartari
Nr. lic. Z 3267

KRYETARI AITPP
VLADIMIR KONOMI

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT**
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS SHTETËRORE**
**DREJTORIA E PRIVATIZIMIT**

Nr. 12666/1 Prot.

Tiranë, më 24.10.2024

Lënda: Kërkohet prononcim për përfshirje të pasurisë në procedurë privatizimi.

**BASHKISË ERSEKË**

**Ersekë**

**Për dijeni: Znj. ALDA ELMAZAJ**
Rr. "Fatmir Haxhiu"Apt.2, Shk.3, Kt.I, "Union Dental Clinic"

**Tiranë**

Pranë institucionit tonë Znj. Alda Elmazaj nëpërmjet kërkesës drejtuar institucionit tonë, të protokolluar me nr.12666, datë 14.10.2024, e cila në zbatim të legjislacionit për privatizimin e pronës shtetërore, ka kërkuar përfshirjen në procedurë privatizimi të objektit "Zyra të ish Fermës lokale Fruti-Kulturë" me vendndodhje në Leskovik, Ersekë.

Për sa më sipër, në zbatim të pikës 2 të VKM-së nr.819, datë 29.11.2007 "Për privatizimin e pasurive të ndërmarrjeve apo të institucioneve shtetërore", kërkojmë informacion nëse pasuria e mësipërme është në përgjegjësi administrimi të Bashkisë Ersekë, si dhe prononcimin për përfshirjen/mospërfshirjen e kësaj pasurie në procedurë privatizimi.

Theksojmë se, në zbatim të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", si dhe të VKM-së nr.926, datë 29.12.2014 "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes" të ndryshuar dhe udhëzimit në zbatim të tij, për të përfshirë në procesin e privatizimit pronat që kanë kaluar në pronësi/administrim të pushtetit vendor, nevojitet miratimi i këshillit të bashkisë i konfirmuar në prefekturën përkatëse, në origjinal ose në kopje të njehsuar me origjinalin.

Gjithashtu, nëse organet përkatëse të qeverisjes vendore shprehen dakord për privatizimin e pasurisë së sipërcituar, në zbatim të VKM-së nr.926, datë 29.12.2014 të ndryshuar, krahas dokumentacionit të mësipërm duhet të dërgoni emrin e përfaqësuesit të institucionit, që do të marrë pjesë në komisionin e vlerësimit.

Adresa: Rruga "Dëshmorët e 4 Shkurtit", Tiranë Web: www.meki.gov.al E-mail: info@meki.gov.al

Sjellim në vëmendje se, procedurat që lidhen me privatizimin, përfshirë edhe caktimi i përfaqësuesit të institucionit në komisionin e vlerësimit, janë kompetencë e titullarit të institucionit administrues.

Bashkëlidhur gjeni kërkesën e subjektit të interesuar si dhe dokumentacionin shoqërues.

Duke ju falenderuar,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Alketa Pernaska

Adresa: Rruga "Dëshmorët e 4 Shkurtit", Tiranë Web: www.meki.gov.al E-mail: info@meki.gov.al

MINISTRIA E EKONOMISË KULTURËS DHE INOVACIONIT
Nr 12666 Prot.
Datë.më 14 10 2024

Deti
14/10/2024

Kerkese per privatizim objekti

Une Alda Bedri Elmazaj banuese ne Tirane kerkoj te privatizoj nje objekt *Zyra (ndertese 2 kateshe )ish Fermes lokale fruti kulture ne Leskovik.

Dua ta privatizoj per ta zhvilluar mbasi bashkia e Ersekes nuk ka interes

Me respekt

Alda Elmazaj

Alda Elmazaj

Tel. 0692049997

Adresa "
Rruga "Fatmir Haxhiu"
Apartamenti 2
Shkalla 3.
Kati I
" Union dental Clinic ".